

Deklaratë për  
Shtyp



**BANKA E  
SHQIPËRISË**

Zyra e Shtypit  
18 tetor 2007

Mbi ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë dhe atë  
valutor gjatë tremujorit të dytë të 2007

**1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË**

1.1 Operacionet e tregut të hapur.

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

| DATA       | Injektivim likuiditeti |                  | Tërheqje likuiditeti |
|------------|------------------------|------------------|----------------------|
|            | R/REPO njëjavore       | R/REPO tremujore | REPO njëjavore       |
| 05.04.2007 |                        |                  | 1,300.00             |
| 12.04.2007 |                        |                  | 1,400.00             |
| 16.04.2007 |                        | 2,000.00         |                      |
| 19.04.2007 | 0.00                   |                  |                      |
| 26.04.2007 | 0.00                   |                  |                      |
| 03.05.2007 | 871.50                 |                  |                      |
| 10.05.2007 | 697.06                 |                  |                      |
| 17.05.2007 | 996.85                 |                  |                      |
| 24.05.2007 | 265.23                 |                  |                      |
| 31.05.2007 |                        |                  | 6,467.00             |
| 07.06.2007 |                        |                  | 5,501.00             |
| 14.06.2007 |                        |                  | 4,879.00             |
| 21.06.2007 |                        |                  | 2,117.00             |
| 28.06.2007 |                        |                  | 1,984.00             |

Në tremujorin e dytë të vitit 2007, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacione për injektimin dhe tërheqjen e likuiditetit, në funksion të situatës së likuiditetit në treg.

Për të injektuar likuiditet Banka e Shqipërisë ka përdorur në një rast marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor, në shumën 2 miliardë lekë; dhe për gjashtë javë të njëpasnjëshme (gjatë periudhës prill-maj) është synuar të realizohet injektimi i likuiditetit nëpërmjet marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor. Mesatarisht, u injektuan 0.5 miliardë lekë në javë.

Për tërheqjen e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e marrëveshjes së riblerjes me maturim njëjavor, në shtatë raste. Në çdo javë të kryerjes së këtij operacioni, janë tërhequr mesatarisht 3.4 miliardë lekë.


## 1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2007, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 1.78 miliardë lekë, pothuajse në të njëjtin nivel me tremujorin e kaluar.

Në kushtet e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim minimal gjatë tremujorit të dytë të vitit 2007, rreth 0.070 miliardë lekë në 10 raste përdorimi.

Grafiku 1 paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2007.




## 2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2007 Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor në kahun e blerjes së valutës, duke synuar shmangien e çrregullimeve të funksionimit të tregut të brendshëm valutor që mund të sillte pozicionimi ndaj ofertës së lartë sezonale të valutës. Si rezultat i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë u shitën rreth 0.82 miliardë lekë.

Grafik 2: Ecuria usd/lek dhe euro/lek (prill - qershor 2007).



## 2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të dytë llogariten në 2,011.97 milionë lekë.

Shuma e blerjeve nga Ministria e Financave për tremujorin e dytë të vitit ishte 52.69 milionë lekë. Ndërsa shuma e blerjeve të valutës nga institucionet e huaja është 85.93 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

Tabelë 2.

| Institucioni financiar | Blerje të valutës (në milionë lekë) | Shitje të valutës (në milionë lekë) |
|------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------|
| Ministria e Financave  | 52.69                               | 2,011.97                            |
| Të tjera (IDA, IBRD)   | 85.93                               | -                                   |